



Mirela Kolli

Drejtor Drejtorie

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Znj. Mirela Kolli është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, ku ka përfunduar studimet Master Shkencor në vitin 2004. Ajo ka ndjekur disa trajnime profesionale në fushën e drejtësisë të organizuara nga institucione ndërkombëtare.

Znj. Kolli ka një eksperiencë të gjatë në sektorin privat ku ka ushtruar profesionin e avokates dhe konsulentës ligjore në fushën e të drejtës civile dhe tregtare. Gjatë kësaj periudhe, znj. Kolli është angazhuar në ndjekjen e një sërë proceseve gjyqësore pranë gjykatave të të gjitha niveleve duke përfaqësuar shoqëri tregtare të mirënjohura në nivel ndërkombëtar.

Në periudhën 2016 – 2018, znj. Kolli ka shërbyer si eksperte e pronësisë intelektuale dhe anëtare e Komitetit të Pronësisë Intelektuale pranë Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, duke kontribuar me dhënien e opinioneve ligjore në fushën e së drejtës tregtare dhe pronësisë intelektuale.


Në vitet 2022 – 2025, është angazhuar si eksperte për hartimin e legjislacionit në fushën e pronësisë industriale.


Znj. Kolli ka filluar punë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike që nga Nëntori 2025 e në vazhdim.

Ajo është njohëse shumë e mirë e gjuhës angleze, si dhe zotëron gjuhën italiane dhe frënge.

Kontakt

 mkolli@klsh.org.al

 Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë
Shqipëri

 www.klsh.org.al